

## Skenderbeu/ Kapiteni Shkempi do te mungoje ne Lushnje

nga AlbaniaSoccer

E martë, 17 Dhjetor 2013 20:18

---



Skenderbeu do te kete nje mungese te rendesishme ne ndeshjen e fundit te ketij viti. Kapiteni Bledi Shkempi ka mbyllur para kohe vitin 2013 per shkak te nje demtimi. Ne ndeshjen me Tiranen, idhulli i tifozerise korcare mori nje demtim muskular dhe nuk dihet akoma periudha e riaftesimit te tij. Shkempi ka marre pushimet para te tjereve por ne Lushnje, ne ndeshjen e fundit per kete vit, ai do te jete si tifozi special i bardhekuqve. Megjithate skuadra e Joses edhe pa Shkempin do te provoj te mos dali pa pike nga fusha e nxehte ne “Roza Haxhiu”.